



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Më: 23 janar 2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 23 janar 2026 në sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 08:30 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Simir Krasniqi, Kryesues i KPF-së, Ymran Fusha, Trëndelina Kastrati, Arianit Berisha, Dafina Alishani, Ilir Gashi, Haziz Hodaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj dhe Shukri Quni, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi – Nënkyetar i Komunës, Levent Bus – Drejtor i Ekonomisë dhe Financave, Lulzim Sylejmani nga drejtorja e ekonomisë dhe financave, Arbër Krasniqi – nga zyra e kuvendit të komunës, si dhe mediat.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): I nderuar nënkryetar i komunës, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, i nderuar drejtor për ekonomi dhe financa zoti Levent, ju uroj detyrën e re të drejtorit, të nderuar përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Për sot kemi thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për politikë dhe financa me një pikë të rendit të ditës, pika e rendit të ditës pra është kjo:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim buxhetit të komunës së Prizrenit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitin 2027 dhe 2028.

Konstatoj se prezent jemi të gjithë anëtarët e Komitetit për politikë dhe financa, nëntë (9) anëtarë dhe kemi kuorum të pranishëm dhe mund të fillojmë me rendin e ditës, nëse nga ju kemi diçka për të shtuar rreth rendit të ditës, urdhëroni? Po Dafina?

Dafina Alishani: Faleminderit kryesues, përshëndetje të gjithë anëtarëve edhe i uroj një mandat të mirë secilit anëtar të KPF-së, unë desha me u informu se a keni pranuar konfirmim të ligjshmërisë për përbërjen e KPF-së, prej MAPL-së.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Po, Dafinë, kemi kontaktuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ata na kanë thënë se gjithçka është në rregull dhe nuk ka problem që nuk kthehet ligjshmëria e vendimit, e kanë përcjellë seancën, votimin edhe gjithçka është në rregull.

Dafina Alishani: A keni marrë diçka me shkrim?

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Me shkrim nuk kemi marrë se e din ti që duhet afati ligjor derisa të na kthehet, por gjithçka do të shkojë në rregull, do të na kthehet ligjshmëria.

Dafina Alishani: Po nëse ne nuk kemi ligjshmëri të shkruar, si ka mundësi me u mbajt KPF-ja kur ose çka është kjo nguti spo e kuptoj?

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Janë afatet e ligjore që na japin që mos të presim 30 ditë deri sa të na vjen ligjshmëria nga MAPL-ja.

Dafina Alishani: Domethënë ju keni marrë konfirmim vetëm me gojë s'ka kurrjë me shkrim nga MAPL-ja, a është ashtu?

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Po kemi kontaktuar, ata na kanë thënë gjithçka është në rregull, nuk do të ketë kurrfarë problemi do të kthehet ligjshmëria e vendimit që ka shkuar procedura në rregull edhe pa kurrfarë problemi.

Dafina Alishani: Nëse bëhet ndonjë shkelje, kush e merr përgjegjësinë?

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Nuk e besoj që do të bëhet shkelje, nuk e besoj! Dikush tjetër, faleminderit Dafinë. Atëherë në qoftë se nuk ka dikush tjetër të diskutojë rreth pikës së rendit të ditës, ja japim fjalën drejtorit për ekonomi dhe financa, fjala për ju, drejtor.

Levent Bus: Faleminderit, përshëndetje anëtar të KPF-së, besoj që i keni marrë materialet me kohë, kështu që strukturat e buxhetit për vitin 2026 është e paraparë, paga dhe mëditje 31.375,952€, mallra dhe shërbime 14.500.234€, shpenzimet komunale 1.069.493€, subvencione 5.521.785€ dhe investime kapitale 22.577.849€. Paga dhe mëditje është e parapa 40.81%, mallra dhe shërbime 19.32%, shpenzime komunale 1.43%. subvencione 7.96%, investime kapitale 3.09%, totalja e buxhetit është para për vitin 2026, 75.045.313€. Që keni ndonjë pyetje prezent është edhe zyrtarit kryesor financiar, zoti Lulzimi, këtu mund me shpjegu më shumë me detaje.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit drejtor, e hapin debatin nga anëtarët e komitetit për politikë dhe financa. Po Dafin fjala për ju.

Dafina Alishani: Faleminderit kryesues, unë desha vetëm u informu rreth borxhit sa është, domethënë këtu sa e pash unë nuk është e përfshirë, por ndërkohë meqë e kanë parë edhe rendin e ditës, shumë operatorë ekonomikë të cilët kanë kryer punë edhe nga viti 2025 po edhe 24, na kanë kontaktuar dhe kanë thënë që faturat të cilat janë realizuar në këto vite fatkeqësisht ende nuk janë paguar, a mund ta dimë sa është borxhi total i komunës së Prizrenit? Edhe operatorët ekonomik, por edhe komplet linjave buxhetore të cilat janë realizuar dhe nuk janë paguar? Unë mendoj që do

duhej që secili asambleist ta di sa është vlera e borxhit edhe ta di pak a shumë se si mund të realizohet ky buxhet. Po ashtu, unë e kam edhe një pyetje kështu, në seancën e parë shumë prej drejtorëve nuk ishin të gatshëm as me na kthy përgjigjen, sepse thanë që nuk jemi as të gatshëm, as ende nuk kemi filluar ashtu si duhet. Sa kanë pasur mundësi drejtorët e ri me punu me këtë buxhet, sepse unë mendoj që ky buxhet është prej drejtorive të kaluara, prej drejtorëve të kaluar, edhe nuk e di tash sa mundemi ne drejtorëve të rinj me ja besu këtë buxhet nëse nuk kanë pas planifikim të duhur ose kohë ata, a është diskutuar mes ekzekutivit të ri? Apo vetëm është si vazhdimësi e ekzekutivit të vjetër, ku edhe do të jetë barrë për këta drejtorë të rinj, të cilët ndoshta dhe as nuk e kanë idenë çfarë borxhi kanë, çfarë përgjegjësie kanë edhe çfarë linja janë të parealizueshme, të cilat këtu janë të përshkruara dhe të planifikuara. Po ashtu janë disa projekte të reja të cilat vetëm janë si projekt të ri, po nuk kanë buxhet adekuat për ... ato ose hiç nuk është ndarë buxheti për 2026. A është kjo vetëm një përbërje e një buxhetit vetëm sa me thënë që ka projekt të ri, e nuk ka buxhet të ndarë apo është ndonjë kërkesë e ndonjë asamblisti që është me patjetër me u tregu këtu në listë, po nuk ka buxhet të ndarë. A mundeni me na tregu për këtë? Po ashtu pyetja ime e fundit është: janë disa projekte të përgjithësuara, nuk është e përcaktuar për shembull ku, çfarë parku do të bëhet, cilën lagje do të bëhet, arsyeja e kësaj? Sepse ju e dini shumë mirë që secila linjë buxhetore duhet ta ketë destinimin e saktë edhe se ku do të shkojë ai buxhet, këto linja të përgjithësuara mendoj që nuk ju bëjnë hajr as juve as asnjë qytetari, sepse le hapësirë për secilën drejtori pastaj pa orientim me investu ose me pas investime kapitale të cilat as nuk kanë planifikim, as nuk kanë buxhetim të duhur, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit Dafinë, po zyrtari për financa Lulzim Sylejmani e ka fjalën.

Lulzim Sylejmani: Përshëndetje, kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së, të nderuar media. Sa i përket borxheve, në shkurt e kemi raportin financiar që do të shpaloset në Kuvend, do të jetë publik dhe aty do të pasqyrohen të gjitha obligimet. Gjatë përgatitjes së buxhetit edhe atëherë në shtator ju kam thënë se nuk është nuk ka qenë shumë e lehtë të përgatitet një buxhet i tillë, për shkak se janë afër 13 milion euro ekzekutime nga thesari ku pjesa prej 75% e atyre ekzekutime vjen nga kontrata kolektive dhe është shumë e vërtetë që e kemi pas të vështirë me i përmbledh kërkesat e qytetarëve edhe gjatë dëgjime publike dhe me e implementu në buxhetin e ri. Borxhet do të raportohen në kuvend në pasqyrat financiare dhe në raportin që do t'i vihet kuvendit në shkurt. Sa i përket drejtorëve të rij, ne i kemi kontaktuar të gjithë drejtorët e rij edhe zyrtarët që kanë punuar me buxhet, faktikisht edhe nuk ka pas hapësirë me e ndryshuar për shkak se shumica prej tyre janë kontrata të lidhura në vazhdimësi domethënë që e përfshin edhe vitin 2026. Projektet e reja nuk janë përfshirë në vitin 2027 për shkak të pamundësisë buxhetore, sepse niveli qëndror është thirr që janë rritur pagat, domethënë po kjo rritja e pagave që i ka kushtuar Prizrenit 4.5 milion nuk është rritja e pagave që ka ardhur në buxhet shtesë prej nivelit qëndror, po thjesht brenda formulës për ndarjen e buxhetit të komunave është implementuar dhe ajo rritja e pagës dhe kapitalet pothuaj me të njëjta me vitin paraprak, sa i përket vlerës. Dhe kjo e ka pamundësuar që ne në vitin 2026 projektet e reja t'i buxhetojmë, përveç disa projekteve më të vogla që kemi mundur t'i buxhetojmë

në vitin 2026. Pjesa tjetër është bartë për planifikimin e vitit 2027. Të gjitha ato projekte të reja kanë ardhur nga kërkesat e qytetarëve që i kemi pas dëgjimet buxhetore dhe ne edhe në bazë të procesverbaleve që janë publike dëgjime buxhetore, jemi munduar t'i pasqyrojmë në buxhet, por jo t'i buxhetojmë në vitin 2026. Te projektet e përgjithshme të sistemi pip në financa, domethënë që ne implementojmë mbas aprovimit në kuvend, aty janë të shpalosura, sepse sistemi pip nuk e lejon ku ke mi çuar pa e përshkruar aty nuk aprovohet, domethënë sistemi nuk e lejon me aprovu nëse ti se ke përshkruar me emër në cilin fshat ose cilin lokalitet ka me shku ai buxhet.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit Lulzim, dikush tjetër. Po Dafinë.

Dafina Alishani: Unë mendoj që nuk ka logjikë me u votu një buxhet nëse ne nuk e dimë sa e kemi borxhin? Domethënë si ka mundësi njëherë me votu buxhetin mandej me diskutuar qysh me ja dalë këtij buxheti. Ju po thoni që buxheti diskutohet ose raportohet në shkurt, unë mendoj që një buxhet, qoftë edhe një buxhet i shtëpisë kur do me ble diçka, duhet më së pari me pa sa ke shpenzime, sa ke borxhe, pastaj me pa me planifiku, me thënë qysh ja dal muajin e ardhshëm.

Lulzim Sylejmani: Unë e thashë që obligimet të cilat janë krijuar gjatë vitit paraprak janë buxhetuar dhe i keni në këtë buxhet.

Dafina Alishani: Sa është totali zotëri, totali buxheti total që duhet me u pagu borxhi total i komunës së Prizrenit sa është?

Lulzim Sylejmani: Unë thashë që i kena 13 milion të ekzekutum nga kontrata kolektive,

Dafina Alishani: Nuk pyeta për kontrat kolektive!

Lulzim Sylejmani: Nëse ti më pyet se tash edhe qysh po e formulon pyetjen domethënë nëse ti më pyet sa janë faturat në pritje për pagesë, domethënë që kanë me u implementu në këtë buxhet, atëherë janë faturat në pritje janë diku 9.5 milion që kanë me u paguar me buxhetin e ri, që kanë fillu faktikisht sepse na 1/12 veq e kena marr buxhetin per dy muj kemi filluar pagesen.

Dafina Alishani:Ju po flitni për 2026, unë po flas 2024/25 fatura të papaguara, unë vetë personalisht kam bërë qasje në dokumente ku kam kërkuar të gjitha faturat të papaguara me kodet buxhetore të cilat nuk janë nuk janë realizuar, fatkeqësisht kam përgjigje gjyshamke.

Lulzim Sylejmani:Edhe unë po them sot në pasqyrat financiare ne kemi raportuar 9.5 milion fatura në pritje që janë për pagesa nga viti paraprakë, edhe ato i takon kategorisë mallrave, kapitaleve, sikur ne të kishim ato mjete që janë ekzekutuar 13 milion, asnjë faturë s'kish mbet në pritje, asnjë hiç bile kishin bërë punë shtesë, dje domethënë nga ekzekutimi i thesarit nëpërmjet përmbarimit kanë mbet edhe ato fatura në pritje që faturat e protokoluuar te me datën 31/12/2025 janë 9.5milion.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit, fjalën e ka Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj: Faleminderit, përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë, unë tu e dit pak problemin e buxhetit edhe atë ditë në seancën e kuvendit, ia tërhoqa vërejtjen që do duhej me u konsultu me ju thoni që jeni konsultuar me drejtorët, në mënyrë që nesër mos me na thënë e kemi pasur një buxhet të aprovuar dhe nuk kemi mund me e realizuar. Kështu që, kërkova që ata të njoftohen me pozicionet buxhetore dhe ta shohim cilat janë mundësitë të realizimit të këtij buxheti. Sigurisht që ky aprovohet për me u realizu, të gjithë sot i kemi sy e vesh edhe qytetarët për aprovimin e këtij buxheti, që nesër të realizohet dhe të kenë të mira prej këtij buxheti. Mirëpo sinqerisht këto raportet e zyrtarit financiar janë dëshpëruese. 13 milion të marrura nga thesari për kontratat kolektive, unë e kam tërheq vërejtjen edhe në seancat e kaluara kur është aprovuar buxheti, që nëse na e dimë që kanë me na i marrë përmbaruesi prej buxhetit, atëherë do të duhet me e paraparë, kontratat kolektive në realitet janë goditje që i bëhet secilës komunë. Ne e kemi parë këtë publikim të këtyre problemeve që kanë komunat me kontratat kolektive, mirëpo kur e dimë që kemi me i dhënë është më mirë me i parapa në buxhet që pjesën tjetër ta planifikojmë dhe t'i realizojmë ato që i kemi mundësi. Dhe ne kemi kritikuar vazhdimisht për suficitin, unë sot personalisht do të duhet të më ndihmonin ekonomistët, nuk e di tash cila është më e mirë a është suficiti a deficitin, se e di që suficiti është tregon paaftësinë e një qeverie për me realizuar projekte, deficitin për me hi në borgj tash cila është kjo, a është super aftësi apo çka është. Shumë problem, pak projekte të reja dhe më shumë pagesë e borgjeve do të kemi në këtë në këtë buxhet realisht. Domethënë nuk duhet me prit shumë qytetarë që ka me pasur realizim të projekteve të reja. Megjithatë, unë kam një propozim konkret, po po e bëj në kuvend, sepse edhe po të votohet këtu, ndoshta, nuk ka vlerë. Kam një propozim konkret për një pozicion të ri buxhetor, unë shpresoj që unë do ta arsyetoj e ju do ta do ta votoni në kuvend, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit, a don të japësh përgjigje?

Lulzim Sylejmani: Po shtoj edhe diçka domethënë, pardje kemi qënë në takim me thesarin edhe me auditorin e përgjithshëm, të gjithë komuna edhe kjo çështja e ekzekutimit nga thesari nëpërmjet procedura përparimit është me të vërtetë është shqetësuese për gjithë komunat, vjen një lëndë me 5€ e 1cent kamatë ndëshkuese për vonesën e pagesës dhe bëhet 337€ nga përmbaruesi për 5€ e 1cent përmbaruesi merr ekspertë financiar me ja kalkulu kamatën dhe ai kalkuluesi i kamatës domethënë eksperti financiar ja merr 79€ domethënë. Zoti Hodaj, pyeti pse s'po na le me buxhetu, ne kemi kërkuar me buxhet të përafërm vlerën e përafërm se ti nuk e dish çka të pret, po kemi thënë për shembull nëse ne vit paraprak i kemi pasur 5 milion, hajde t'i ndajmë nja 6 milion, t'i alokojmë te fondi rezervë dhe paraqitet kërkesa e saj. Domethënë nuk po lënë asnjë farë forme sepse fondi rezervë nuk është kategori shpenzuese, po thotë ti mundesh me i lënë në fondin rezervë, po për çdo kërkesë çdo dy javë tre javë çdo dy ditë duhesh me thirr kuvendin me ta aprovu, ku duhesh me qu në asamblenë komunale, nuk është funksionale se kanë bërë asnjëra prej komunave.

Haziz Hodaj: S'keni nevojë ju me thirr kuvendin për çdo kërkesë, po ato bëhen kërkesat, në fund muajit seancën edhe ja provojmë.

Lulzim Sylejmani: Me ligjin e buxhetit aktual domethënë thotë ashtu domethënë që është e pamundshme, ne kemi kërku bënë një ndryshim dhe po krijojmë një fond rezervë në momentin kur paraqitet kërkesa, ti ekzekutoni aty, po ti ekzekutoni ju drejt thesari pa na pyet hiç. E kemi fondin në rezervë u paraqit nevoja, u paraqit vendimi, ekzekuton aty dhe në bazë të kategorisë së shpenzimit nëse është kontratë kolektive i takon pagave, nëse është fatura e operatorëve ekonomik i takon kapitalet dhe ekzekutohet prej qatij fondi, nuk po dojnë! I njëjti ministër vazhdimisht kontratën kolektive e quan të paligjshme, i njëjti ministër menaxhon thesarin dhe ekzekuton kontratën e paligjshme, domethënë të gjithë po dimë ku është problemi, por nuk po dua me adresu problemin dhe kjo ka me vazhdu edhe në vitin 2026, për shkak se disa prej operatorëve që kanë punuar dhe që ju kanë marrë parët nga linjat e këty për pagesën për punët e kryerve kanë me u detyruar me i dërguar në thesar, sepse është e pamundshme me ja kry obligimin që e ka. Domethënë edhe nëse zvogëlohet në këtë vit kontrata kolektive kanë me rrit obligimet ndaj operatorëve ekonomik.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit, fjalën e ka Arianit Berisha.

Arianit Berisha: Përshëndetje të gjithëve, veç e sqaroj pak më shumë ato që pata me pyet, por edhe njëherë të bëj si pyetje direkte për Lulzim, me u ndërlidh me atë që tha Dafina, domethënë këto fatura në pritje që janë 9.5 milion euro janë të shpërndara në këto projekte që janë trashëgim nga viti i kaluar apo? Faleminderit!

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit Arianit, fjalën e ka Shukri Quni.

Shukri Quni: Faleminderit kryesues, përshëndetje në punë të mbarë Komitetit për Politikë e Financa, urime edhe juve drejtor. S'po di tash drejtor, tash më i fundit e kemi marrë këtë detyrë të sa je rreth i njoftuar rreth këtij projekt buxheti, i cili është shumë i mangët tash ju hytë edhe te borxhet, po unë e di që aty te te financat shkojnë njerëz që kuptojnë ato punë, se me më çu mu kush e di çka kisha bë, kisha shkuar në burg se është puna me me pare s'merr vesh me këto hiç kurrjë. Po e them këtë që drejtorë të cilët po vendosen nëpër pozita, atë ditë na tha kryesuesi që bile mua edhe ty Haziz na lëshoi këtë, tha, nuk merrni vesh se nuk jeni ekspertë, në atë komisionin që e propozuam ne. E për eksperta i kemi lënë juve, po qysh po e shoh unë send nuk shoh që keni me kryer diçka ose me ja pa hajrin qytetari. Unë kjo mbledhje edhe për buxhet kjo është shumë shpejt, domethënë edhe pa drejtuar s'ke çka të diskuton, ky buxhet ka qenë dashur me u votue në shtator, a është ashtu? Nënkryetari, pse s'u votu ju e dini shumë mirë, i bletë asambleistat, me në fund ju la në lloq! Kjo është jo seriozitetin në punë, këtë e kam cekur edhe në kuvend, asamblesitin kur ta blenë bile deri në fund, edhe thua çu dorën edhe ta votoj edhe projekt buxhetin qe mos ti lemë drejtorave te ri një punë që nuk kanë njohuri rreth ksaj. Për mua ky projekt-buxhet që është hartuar nuk ka kurrfarë vlere, e kam fjalën për qytetarët. E do të votohet se shumicën e keni prapë dhe keni me e votu, unë nuk e votoj për arsye se ky projekt buxhet tha dhe zyrtari është përpiluar prej qytetarëve nëpër debate që është mbajtur me qytetarë, në ato vende ka vi unë, fare nuk janë hy ato kërkesa. Për borxhet i thatë ju ato so problem ato diskutu. Mvaret tash Haziz qe tha me shku mjetet në suficit ose me të mbetë ose me çu tepër me e kuptu pak më thjeshtë. Ne kemi pas kryetarë

që kanë çuar suficit vjete me miliona, po edhe kjo me të rrasur në borxh e mos me mundur me kryer punë të tjera edhe kjo nuk është në rregull. Këtu janë njerëz që kanë këtu ka përgjegjësi, unë thashë me ma ngarku mua një punë që nuk kam njohuri, unë duhet ma kallzu vendin ku kam. Nëse shkojmë ne për hatër, ne gabojmë shumë, ne jemi të votuar prej qytetareve me e mbroj paren e tij, me i mbrojt taksat, me dediku atje ku është e nevojshme, jo ka dojm me i çu ose me investu nëpër ato vende të cilat e ka elektoratin. Hazizi tha kam disa propozime, po ne për këtë jemi ne duhet edhe me propozu, fshati Mazrek, fshati Kojush, fshati Planej, Gorozhup as nuk figurojnë këtu, nese i ka taku dikush në të më tregojë, për një që është në Gorozhup ajo është kry e renovimit të shkollës. Bile u lavdu ai drejtori Zenuni, e pat qu drejtoreshën e kryetari në qiell, ktu tash figuron apet që duhet me investu në të. Pastaj ka shumë fshatra po edhe lagjen për shembull lagja Jeta e Re quhet çfarë jeta e re, ajo është lagja jeta zezë aty kanalizimi del në rrugë në rrugë del, çka më e keqja e shpëraz grupën skeptike dhe e gjuan në asfalt edhe inspektoriat, i thonë a mos dimë ne çka ka atje, pa na thirr dikush! Në çfarë gjendje kemi ardhë tash i kërcënu dhe njerëzit me mbrojt pasurinë e vet. Aty me pas u vendos këtu që i keni ba debatet me qytetarë, ka qenë dash se ka qenë kërkesa edhe e jemja po edhe qytetarëve, kanalizimi për lagjen Jeta e Re për rrugën që shkon për Nashec, aty derdhën komplet në asfalt, i kam me inçizim edhe hiç s'ka dert veç e fut në atë gropën aty dhe e gjuan nga përmi mur e gjuan në asfalt në rrugë. Edhe tre katër ditë nuk i hiqet era. E pata që është ba ky projekt buxhet me debate me qytetarë edhe janë shpërnda ato nëpër gjitha ato vende ku ka pas kërkesa, jo, nuk është ashtu. Meqenëse drejtorin tash nuk po e akuzoj asnjë send, se ky dje e ka marrë detyren a pardje, domethënë ky veç sot, ka ardhë formalisht edhe kjo mbledhje po konsideroj që është më shumë formalisht. Edhe njëherë ky duhet me u përpunuar, nëse dojm me ba diçka dhe ky duhet me u përpunuar mos hij tash në detaje se ka shumë që nuk janë përfshi në në ato pjesë ka gjithnjë po flas, më shumë flas në ato pjesë ka vi i ceka disa vende të cilat nuk janë përfshin fare, nuk figuron emri i tij hiç s'ka emër, nuk ka emër ku ju, nuk ekziston në 74 fshatra të komunës së Prizrenit edhe fshatra të tjera ka në Zym e ka plot, po disa fshatra figurojnë nga pesë gjashtë herë, se çka do të bëjnë aty tash nuk e di për shembull fshati Grazhdanik pesë gjashtë vende figuron, jo kanalizim jo mur ato janë kryer të gjitha tash unë s'po di çka ka tash me investu, nëse borxhe të pakryer këto borxhe të pakryme?

Lulzim Sylejmani: Ka obligimet që kenë met, tash janë përfshi në buxhet dhe nëse një punë është kryer në shtator tetor në Grazhdaniku ku po përmendi ti dhe ajo atij projekti gjatë vitit 2025 që po i marr mjetet ka qenë dashur të buxhetohet dhe të paguhet obligimi, unë e ceka po.

Shukri Quni: Po ti e ceke po unë unë i kam këto vjet, duhet edhe ne bile në arsim që punojmë thu përsërit edhe njëherë. Mos e merr ti ata që unë se kam kuptuar dhe të kërkoj me ma sqaruar edhe njëherë, për shembull në drejtorinë e turizmit s'di sa më ke përcjellë në kuvend, më duket kish ba edhe bajat tu e përmend atë parkun atë parkin e famshëm në Nashec. 285.000 euro drejtar pare janë ato, këto i kam thënë asamble nuk po drejtohem personalisht mos e merr personale të lutem. Ju e dini koleg 285.000 euro me i numëruar ne këtu tash i bëjmë një javë valla, janë goxha do pare, a i kam qu mediat a kemi ba lloj lloj reklame i kam ba reklame, çfarë reklame, e kam kundërshtu. Puna s'është kryer, nuk figuron në drejtorinë e turizmit fare, e kishin paraparë pushimore Nashec

me investu, prapë kush e ka bërë atë propozim mbi 550.000 euro, a e dini sa here është investu aty. Kolegët e dinë sa herë e kam cekë unë atë, ka investu Gjergj Deda nja 2-3 milion, apo don ka investue shoqata Miqtë e TMK-së kan ardhë ja 4-5 vjet, pastaj krejt ato i mbulojë ish kryetari Mytaher Haskuka kur e bani karantinë, mos investoni se s'ka nevojë, se ato çfarë po doni ju jani aty, edhe ai i mbroj ato, krejt, me ardhjen në qeveri para tash katër vitë të Shaqir Totës, prap ka investu, mos investo, mos i mbulo hajnit e tjera, kështu i kam thënë kush e mbanë mend. Tash u parapa prapë, tash nuk e di unë qysh, unë do ta votoj këtë, se ju e dini shumë mirë që unë buxheti që është i përpiluar mirë, kurrë s'jam ndikuar prej partisë, si kudo qof, se un kam ardhë për qytetarët më në fund. Ka çka me u diskutu, po e shoh që është vonë për këtë projekt buxhet, është vonë, e votoni, e di që keni me votuar, por për qytetarin kjo s'ka me pas asgjë diçka që ka me sjellë.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit, e don dikush tjetër fjalën.

Haziz Hodaj: Kjo çështja e kësaj pushimores Nashec për një mend nëse nëse nuk dihet për çka ka me funksionu, pse me investu vjet për vjet në të edhe edhe kur çfarë funksioni nuk kryen ajo. S'di pse është paraparë sa investimet janë bërë në të ajo asnjë funksion nuk e kryen, përveç se përveç se shkatërrohet tu nejt për se nuk kryen ndonje funksion hiqe prej buxhetit, kur ti vjen koha me shti në funksion le të investohet.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Po, fjalën e ka Ilir Gashi.

Ilir Gashi: Përsëritje të gjithë anëtarëve të KPF-së, zoti kryesues ne qdo vjet kur e kemi buxhetin dalin kështu dilemash, temash, kërkesa të anëtarëve edhe natyrisht disponimi i ekzekutivit nuk është që me bërë ndryshime në buxhet, po çdo herë vjen propozimi i njëjtë, ta kemi një takim, një seancë, ku analizojmë buxhetin, japim propozime për me shtu, me heq, me amandamentu dhe pastaj në seancën e radhës ajo votohet, pasi që ekzekutivi edhe njëherë e bën një rirregullim, po kështu buxheti i gatshëm paramendo vetëm KPF, sa kundërshtime po dalin dhe si do të dalin në seancë, ka shumë linja paqarta buxhetore, ka shumë mangësi, ju i di i keni votat, keni me kaluar sërish, po puna nuk po bëhet ashtu qysh duhet. Edhe paraja publike nuk po kanalizohet aty ku kanë nevojë qytetarët, por aty ku individ të caktuar ekzekutivit mendojnë se duhet me kanalizohet.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Faleminderit, po fjalën Dafina Alishani.

Dafina Alishani: Për fund edhe njëherë, për hir të korrektësisë ne qëndruam që me pas edhe diskutime po edhe me u informu edhe anëtarë të tjerë domethënë, po edhe me i pasur pyetjet për zyrtarin këtu. Po mendoj që prapë edhe njëherë domethënë me atë që në fillim na pa një ligjshmëri zyrtare e cila është e shkruar, unë mendoj që kjo KPF nuk e di sa e ka mandatin me e diskutuar buxhetin edhe me marrë një vendim. Propozoj që derisa të vjen një konfirmim ligjor i përbërjes së KPF-së, mos të ngutemi me e bë këtë votim.

Haziz Hodaj: A ka ndonjë kontest për ligjshmërinë?

Dafina Alishani: Unë zakonisht kur pyes diçka se zakonisht ne jemi jemi aprovu gjithmonë prej kësaj qeverisje që ka konfirmim, po në fund kanë ardhur shumë vendime të cilat ne duhet me i votu ose me i mos me i votu ose me i anuluar vendimet. Unë kam dyshimet e mia në votimin e komiteteve të përhershme në kuvendin e kaluar. Ka shumë ankesa të cilat janë bërë individualisht, edhe tash unë për shkak që e kam këtë dyshim të konfirmimit, unë me gjithë respektin Simiri e tha, po mendoj që tash e mas çfarëdo që merret si konfirmim duhet neve me na ardhë me shkrim. Ne nuk mundemi me aludime, kemi kontaktuar, i kemi thënë, na kanë thënë a e din, ne kemi pasur shumë informata në këtë KPF që kanë thënë kemi marrë konfirmim prej ministrisë, në fund na ka dalë që s'kanë marrë konfirmim prej ministrisë, e para. E dyta zyrtari, këtu se di a është shërbyes civil, a është politik? Me gjithë respektin, po konkludimet politike që i keni në raport me nivelin qëndror ish dashur me kanë të barabartë dhe me nivelin lokal. Ne jemi shumë të informuar, pa aftësinë e qeverisjes së kaluar, se sa milion euro janë bë keq menaxhim, janë bë keq klasifikim. Ne kemi pasur buxhet ku kanë marrë prej pagës dhe mëditjes dhe kanë shpenzuar në asfalt, ju e dini shumë mirë atë edhe ka pas shumë kritika në kuvend. Po ashtu domethënë vazhdimisht kur flitet për borxh, kur flitet për suficit, kur flitet për mbetje, kur flitet për deficit, interesant gjithmonë është fajtor nivelit qëndror, kurrë asnjë drejtor nuk e merr përgjegjësinë me thënë mirë zonja, zotërinjë, nuk kam ditur me shpenzuar buxhetin, nuk kam ditur me planifikuar, kam pasur kërkesa të ndryshme, a e din, gjithmonë e pa që ai ministri i njej që paska akuzuar juve, tash po bën kësi lloj problemesh që juve po ju pamundëson me operu. Zotëri, buxhetin kur e bën edhe kur nxjerr një projekt të ri, nëse i ndan 10.000€ me një projekt që është 200.000€, normal që ti ke me hy në borxh. Ne jemi kundër këtyre domethënë buxheteve të cilat ju linjat i nxirrni vetëm sa për sy e faqe, kurse realizimi është i pamundur. Ju e dini shumë mirë edhe në mandatin e kaluar e keni buxhetuar një shtatore maza më keq 15.000 euro, kurrë su bë ajo shtatore. A është ashtu baca Haziz? A u bë shtatorja Ibrahim Rugovës,

Haziz Hodaj: Nuk u kanë 15.000, por 50.000 euro.

Dafina Alishani: Këto lloj buxhetime që i bëni ju edhe tash që i akuzoni nivelin qëndror është sinqerisht është e pakuptueshme. Ju me dashur me qenë transparent ma bëni këtë, thuni borxhi total është kaq, kaq janë marrë ju po e përmendi vetëm kontratën kolektive, borxhe të tjera s'po i përmendni? Pse, sepse keni begraund politik. Sepse ju këtu si shërbyes civil na uleni dhe bëni qëndrime politike që nuk është hiç në rregull, është nuk është hera e parë, shumë herë ju keni pas këtu konkluidime politike që nuk ju takon juve, ju jeni pjesë e komunës së Prizrenit. Për fund, ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk marrim pjesë në këtë KPF, për shkak që kemi dyshimet që nuk kemi konfirmim të ligjshmërisë, ju bëjmë thirrje edhe juve ta presim konfirmimin ligjshmërisë, mos të bëjmë hapa të gabueshëm, sepse buxheti duhet të diskutohet në KPF, më pas duhet të rekomandohet për rend dite, kështu që ju faleminderit e kalofshi mirë.

Haziz Hodaj: Ju morët pjesë, tash u kry kjo.

Dafina Alishani: S'mora pjesë në votim,

Kujtim Gashi: Është justifikim, te tregoj që është konsultuar me ministri dhe jemi konsultuar me ministri, në momentet kur vendimin e merr kuvendi është i ligjshëm derisa nuk ka konfirmim, a din ti që mundet hiç mos me ardhë konfirmimi.

Dafina Alishani: Jo, për komitetet obligative duhet konfirmim.

Kujtim Gashi: Kështu që ministria e ka konfirmu këtë dhe është në kabinet.

Dafina Alishani: Ka shumë veprime që ju keni thënë i kemi marrë konfirmime prej ministrisë edhe nuk ka ardhë konfirmimi.

Kujtim Gashi: Fatmirësisht që s'kemi nevojë për vota të tua.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Se nuk desha t'i përsëris fjalët e njëjta që ja thashë në fillim.

Shukri Quni: Nënkryetar ky nuk është, mirë të ka thënë atë ditë që tha mos e udhëheq mbledhjen ti, po është kryesuesi, e kemi votuar ne këta. Po nuk është në rregull a je lazën ti për votën time a sje?

Kujtim Gashi: Nuk e lejoj unë me luft me një qytet, njerëzit që kurrë s'ka dhënë asnjë kontribut për këtë qytet, e parëndësishme është.

Shukri Quni: E ka votën e vet, mos harro, e ka pru dikush.

Simir Krasniqi (Kryesues i KPF-së): Kështu po ndërlihdna edhe njëherë se s'desha t'i përsëris fjalët e njëjta, ne kemi kontaktuar me ministri, ne kemi respektuar ligjin për vetëqeverisjen lokale, udhëzimin administrativ për përzgjedhjen e komitetit KPF-së, komitetit për politikë dhe financa, e kemi respektuar kuotën gjinore, gjithçka ka shkuar në rregull edhe nuk ka arsye. Ne patëm një takim edhe ishte prezent. Mirë vazhdojmë, ka dikush tjetër ta marr fjalën. Atëherë, në qoftë se nuk hedhim në votim rendin e ditës që t'i rekomandojmë mbledhjes së kuvendit, konstatojmë se prezent jemi shtatë (7) anëtarë të komitetit për politikë dhe financa. Kush është për që t'i rekomandohet kuvendit pika e rendit të ditës? Gjashtë (6) për. Kush është kundër? një (1) kundër. Abstenime nuk ka. Atëherë kjo pikë e rendit të ditës i rekomandohet kuvendit. Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe këtu e mbylli.

Mbledhja përfundoi në ora 9:15.


Kryesuesi i KPF-së
Simir Krasniqi
Simir Krasniqi